

DITA

Search something..

KREU

OPINION

POLITIKË

EKONOMI

BOTË

KRONIKË

SPORT

KULTURË

HISTORI

DITA TV

LIFESTYLE

JETA NE CIFT

KOPERTINA

SHKARKO & REGJISTROHU

NË MY TELEKOM APP

+3GB

DHURATË

More në Google Play

Shkarkë App Store

MY TELEKOM

U arrestua dje me armë para PS-së, nis hetimi pasuror për Vladimir Gjutën

February 11, 2020 13:48

Media Sociale
Ndaje me miqtë

Printoje

Nise me e-mail

PAGESA DHE TRANSPORTA
PËR BIZNESIN TËND?

Nga Arkiva

- Bombardime nga ajri në dasmë, 20 të vrarë, mes tyre edhe nusja
23.Apr
- Të zhveshur, me mbishkrime në trup, protestuesit e klimës marshojnë në rrugët e Australisë
12.Oct
- Bularati/ Ish-drejtuasi: RENEA s'merr urdhër për armët, veproi sipas ligjit
29.Oct

Policia e Tiranës ka nisur hetimin pasuror ndaj Vladi Gjutës, të arrestuar një ditë më parë para selisë së Partisë Socialiste, pasi tentoi të hynte brenda i armatosur, teksa po zhvillohej mbledhja e Kryesisë së PS, ku i pranishëm ishte edhe kryeministri Edi Rama.

Njoftimi i policisë:

Tiranë

Drejtorja Vendore e Policisë Tiranë, në bashkëpunim me prokurorinë, nisi hetimin pasuror ndaj shtetasit V. Gj.
40-vjecari V.Gj, i arrestuar një ditë më parë nga Komisariati i Policisë Nr. 3, pasi u kap me armë zjarri me vete dhe një shumë të madhe parash.

Sekuestrohen në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë, municion luftarak dhe shuma të mëdha parash.
Sekuestrohet edhe një automjet i blinduar që e kishte në përdorim 40-vjeçari V. Gj.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, në rrugën “Çamëria”, rreth orës 08:45, të datës 10.02.2020, bënë kapjen dhe arrestimin në flagrancë të shtetasit V. Gj, 40 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë.

Në momentin e kapjes nga Patrullat e Përgjithshme të Komisarariatit të Policisë Nr. 3, këtij shtetasi iu gjetën me vete një armë zjarri pistoletë me municion luftarak, një dorezë grushti metalike, si dhe një sasi e madhe parash në valutë dhe lekë shqiptare.

Shërbimet e Policisë, në bashkëpunim me Sektorin për Krimin Ekonomik e Financiar dhe atë të Krimeve ndaj Jetës dhe Personit në DVP Tiranë, kanë ushtruar kontroll në banesën e këtij shtetasi, ku kanë gjetur dhe sekuestruar edhe shuma të tjera parash.

Në total iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale:
121.100 euro, 27.500 dollarë amerikanë, 22.970 paund anglez dhe 664.500 lekë të reja.

Po gjatë kontrollit të banesës së shtetasit V. Gj, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan edhe një mjet të blinduar autoveturë Audi A8, me të cilën qarkullonte ky shtetas.

Në vijim të veprimeve, nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka nisur hetimi pasuror për shtetasin V. Gj.

Në përfundim të veprimeve, materialet iu referuan prokurorisë, për veprat penale “Armëmbajtja pa leje”, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

o.j/dita

1 KOMENT

Komento

mirel

Hetim pasuror, thote defidenti mendor i Dites.
Sinoptikan i papare

Reply to this comment

KOMENTO

Shiko komentet

Your e-mail address will not be published.
Required fields are marked *

Komenti *

Mesazhi juaj..

Nickname *

Nickname..

E-mail *

E-mail..

Website

Website..

Posto komentin

© Copyright Gazeta Dita
E përditshme e Analizës dhe e Informacionit. Numri i parë, 1 nëntor
2012. Botohet nga "Publikime Shqiptare". Kryeredaktor Adrian Thano.
Adresa e redaksisë: Rruga "Donika Kastrioti", Tiranë. Zyra e Botuesit:
Rogner Hotel, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë
Designed by MCN.AL